

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Si po i shpëton hetimit të SPAK Adrian Bardhi i “Pascucci”; ortaku i Ergys Agasit te “Dinamo” dhe pjesë e grupit të tij kriminal - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/si-po-i-shpeton-hetimit-te-spak-adrian-bardhi-i-pascucci-ortaku-i-ergys-agasit-te-dinamo-dhe-pjese-e-grupit-te-tij-kriminal/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:10:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 21:45:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5f8bf4d7b0684387e78accdeddfbe2c8bdc0d47b49263f02416ef457661766ca
TEKSTI	76d77e91e453a02a64b11de60c7e096bef0277ad52fa7560bcfee577c4f62337
PAMJA	9a2c8b4357b63896b8da71fe70c0c792fa423a365c241046bed003dec905f491

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6fff422ab9f665c76322dba41b3b6673a037be7ea2fe1ea4a6854d0b574857d6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/6fff422ab9f665c76322dba41b3b6673a037be7ea2fe1ea4a6854d0b574857d6

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Si po i shpëton hetimit të SPAK Adrian Bardhi i "Pascucci"; ortaku i Ergys Agasit te "Dinamo" dhe pjesë e grupit të tij kriminal

by Sport Sport — September 22, 2026 in Aktualitet, Kronikë, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Operacioni i mëngjesit të sotëm i SPAK goditi një pjesë të rëndësishme të grupit dhe bashkëpunëtorëve të Ergys Agasit, por në listën e kontrolleve dhe masave të sigurisë nuk u shfaq emri i Adrian Bardhit, biznesmenit të kafes Pascucci dhe ortakut të dokumentuar të Agasit në Dinamo City, një mungesë që në qarqet e hetimit po lexohet si lënie e qëllimshme jashtë dosjes.

Marrëdhënia mes Adrian Bardhit dhe Agasit nuk është e fshehtë. Më 25 gusht 2023, pikërisht në Villa Pascucci të Bardhit në Durrës, u prezantua projekti i ri "Dinamo City" dhe në atë aktivitet Ergys Agasi u shfaq publikisht bashkë me Edmond Shahinin e Mektrin dhe Genc Matajn si një nga aksionerët e rinj të klubit. Ky prezantim ndodhi rreth shtatë muaj përpara se Agasi të hynte zyrtarisht në pronësi më 31 mars 2024, kur Bardhi i transferoi 30% të aksioneve dhe regjistrimi u pasqyrua në QKB në fillim të prillit.

Struktura e Dinamo City deri në qershor 2026 vijon të jetë Adrian Bardhi 40%, Ergys Agasi 30% dhe Fortis Beton 30%, ndërsa Bardhi mbetet në strukturën drejtuese të klubit. Administratori i Dinamos është Ilir Sinani punonjës i "Pascucci", çka tregon se struktura operative e klubit është e ndërthurur me ekosistemin e biznesit të Bardhit.

Më 2 shkurt 2024, fondacioni Dyrrah City Football Academy hapi procedurën për klubin që do të financonte ndërtimin e kompleksit të akademisë së futbollit në Durrës. Agasi hyri zyrtarisht në pronësinë e Dinamos në fund të marsit, ndërsa më 24-25 prill 2024 Dinamo City shpallet fituese dhe ishte i vetmi klub që kishte paraqitur ofertë. Kontrata u nënshkrua më 20 maj 2024 dhe afati i saj zgjat deri më 20 prill 2034, sipas një dokumenti të Ministrisë së Arsimit të vitit 2025.

Sipas burimeve, Adrian Bardhi ka qenë pjesë aktive e grupit Agasi, i fotografuar nën shoqërinë e tij në rezidencën Kodra e Kuajve, në ambientet e vilave qeveritare Durrës, si dhe në ambientet e Villa Pascucci. Mes tyre ka ortakëri të dokumentuar, injektim fondesh kriminale, pastrim parash dhe afëra të tjera duke nisur nga Kadastra e Durrësit, KKT, lejet për fotovoltaike etj.

SPAK duhet të thotë pse emri i Adrian Bardhit nuk u përfshi në aksionin e sotëm, ndërsa burimet e hetimit pretendojnë se dosja vijon dhe se gjurmët e grupit të Agasit nuk mbyllen me kaq. /Pamfleti

Tags: Ardian Bardhi dinamo Ergys Agasi Pascucci

TË FUNDIT

Tifozi i Manchester United është bërë i famshëm, Haaland i bën komentin epik: Priti flokët, shoku!

SEPTEMBER 22, 2026

Si po i shpëton hetimit të SPAK Adrian Bardhi i "Pascucci"; ortaku i Ergys Agasit te "Dinamo" dhe pjesë e grupit të tij kriminal

SEPTEMBER 22, 2026

Nis beteja në Apel për katër ish-krerët e UÇK-së

SEPTEMBER 22, 2026

Presidenti i Federatës Gjermane sulmon Infantinon: Një manovër e qartë për të qëndruar në pushtet

SEPTEMBER 22, 2026

BE zgjat sanksionet ndaj Rusisë me 3 vjet

SEPTEMBER 22, 2026

"Nesër më shumë!" - Përfundon protesta e 115-të antiqeveritare, qytetarët të vendosur në qëllimin e tyre: Edi Rama, dorëhiq!

SEPTEMBER 22, 2026

"Zbatim më i fortë i ligjit"- Mesazhi i ambasadës amerikane: Kur SHBA dhe Shqipëria qëndrojnë së bashku, komunitetet tona janë më të sigurta

SEPTEMBER 22, 2026

Protesta/ Arben Kola: Vlora Hyseni, na e fëlliqe emrin e qytetit! E ke kthyer SHISH-in në fole të UDB-së!

SEPTEMBER 22, 2026

Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e Vlora Hysenit nga drejtimi i SHISH

SEPTEMBER 22, 2026

Aksident në Lezhë, vdes 50-vjeçari

SEPTEMBER 22, 2026

Previous Post

Nis beteja në Apel për katër ish-krerët e UÇK-së

Next Post

Tifozi i Manchester United është bërë i famshëm, Haaland i bën komentin epik: Priti flokët, shoku!



Sport Sport

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja
mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01



Është studente ekselente, e birësuar nga një çift grek / Trondit avokati: Bleona Mata është gjallë

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2 zyrtarë në Tiranë

0 SHARES